



Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Familjëve
Coalition of NGOs for Child Protection
Koalicija NVO-ja za Zastitu Dete

RAPORTI VJETOR 2024

RRETH KOMF

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, i themeluar në qershor të vitit 2011, është një koalicion i përbërë nga 34 organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

MISIONI

Misioni i Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve është avokimi për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve.

VIZIONI

Një shoqëri ku secili fëmijë realizon të drejtat e garantuara në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës.

OBJEKTIVAT

- Avokimi për iniciimin dhe miratimin e ligjeve dhe politikave për fëmijët.
- Monitorimi i zbatimit të ligjeve dhe politikave për fëmijët.
- Sensibilizimi dhe mobilizimi i autoriteteve shtetërore relevante në nivel lokal dhe nacional, sensibilizimi i ofruesve të shërbimeve dhe aktorëve të tjerë në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
- Rritja e vetëdijesimit tek opinioni i gjerë për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve pa dallim.
- Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të gjitha grupeve që janë më të ekspozuara ndaj shkeljes së të drejtave të fëmijëve.
- Krijimi i hapësirave për zhvillimin e praktikave më të mira në fushën e të drejtave të fëmijëve, dokumentimi dhe ndarja me të gjithë anëtarët e koalicionit.
- Fuqizimi i kapaciteteve të koalicionit, veçanërisht fuqizimi i organizatave lokale dhe organizatave të bazuara në komunitet.



Remzije Krasniqi
*Presidente e Koalicionit të OJQ-ve
për Mbrojtjen e Fëmijëve*



Donjetë Kelmendi
*Drejtorë Ekzekutive e Koalicionit të
OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve*

ÇFARË KEMI ARRITUR SË BASHKU PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NË KOSOVË GJATË VITIT 2024?

Viti 2024 ishte jashtëzakonisht sfidues për fushën e mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë, veçanërisht në aspektin e financimit të shërbimeve sociale dhe familjare. Me përfundimin e programeve të mbështetura nga donatorët ndërkombëtarë në dhjetor 2023, një pjesë e madhe e ofruesve të shërbimeve sociale u përballën me rrezikun e mbylljes ose reduktimit drastik të shërbimeve për fëmijet në fillim të vitit 2024.

Përballë kësaj krize, si Koalicion u mobilizua fuqishëm për të gjetur një zgjidhje emergjente për financimin e shërbimeve. Përmes angazhimit të përbashkët, arritëm të ndikojmë në parandalimin e mbylljes së shërbimeve dhe rritjen e buxhetit për financimin e shërbimeve sociale.

Përmes monitorimit të zbatimit të legjislacionit me anë të Kartës së Vlerësimit, dokumentuam situatën e të drejtave të fëmijëve në fushat e mirëqenies sociale, mbrojtjes së fëmijëve, zhvillimit në fëmijërinë e hershme, arsimit, shëndetësisë dhe drejtësisë për të mitur, duke ofruar mbi 120 rekomandime për institucionet publike dhe vendimmarrësit.

Mbështetëm hartimin e Programit të ri Kurrikular për fëmijë në sistemin e drejtësisë për fëmijë, në fushën penale dhe civile, me qëllim të rritjes së kapaciteteve të profesionistëve të drejtësisë në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe drejtësinë për të mitur, ku rreth 5,000 fëmijë në kontakt me ligjin do të marrin trajtim më të mirë.

Jemi krenarë për forcën e organizatave anëtare në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe arritjet e përbashkëta për fëmijet në Kosovë.

Të vazhdojmë së bashku, me edhe më shumë forcë dhe përkushtim, për të ndikuar pozitivisht në jetën e çdo fëmije në Kosovë.

ÇFARË KEMI ARRITUR SË BASHKU NË VITIN 2024

Puna e KOMF në vitin 2024, në numra

Falë punës dhe përkushtimit të organizatave anëtare të KOMF dhe Sekretariatit, së bashku arritëm të përmirësojmë jetën e mijëra fëmijëve dhe familjeve në Kosovë.

Punuan për të siguruar rritjen e financimit për shërbimet sociale. Si rezultat, buxheti u rrit nga

1.5 në 2.5 milionë,

ku më shumë fëmijë të cenusëm do të kenë qasje në shërbime më cilësore.

Mbështetëm hartimin e kurrikulës për fëmijët në sistemin e drejtësisë, ku rreth

5,000 fëmijë

në kontakt me ligjin (si viktimë, dëshmitarë apo kryes të veprave penale) do të përfitojnë trajtim më të mirë në sistemin e drejtësisë.

Avokuam për politikat për fëmijë në

24 grupe

punuese dhe 6 trupa/mekanizma për mbrojtjen e fëmijëve.

Adresuam më shumë se

120 rekomandime

të Kartës së Vlerësimit drejt vendimmarrësve.

Rreth 300 përmendje në media dhe rreth

1.5 milion

arritje në rrjete sociale.

Publikuam rreth

20 letra,

opinionë dhe qëndrime të dërguara institucioneve.

Mbi 30 iniciativa

avokuese, konferenca nacionale, përfshirë 7 tryeza për prezantimin e "Kartës së Vlerësimit 2024" për komunat dhe një sërë ngjarjesh tematike.

Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet avokuese:

mbi 600.

Ngritëm kapacitetet e KOMF dhe organizatave anëtare në kuadër të Programit për Ngritje të Kapaciteteve.

Raporte dhe dokumente analitike

Publikimi i raportit të monitorimit "Karta e Vlerësimit 2024:

Cila është nota mesatare e shtetit në përkujdesjen ndaj fëmijëve?"

Publikimi i raportit të monitorimit "Karta e Vlerësimit 2023:

Cila është nota mesatare e shtetit në përkujdesjen ndaj fëmijëve?"

Programi për Ngritjen e Kapaciteteve për organizatat anëtare.

Kontribut autorial në Raportin Kryesor të Eurochild.

ÇFARË KEMI BËRË PËR MBROJTJEN SOCIALE TË FËMIJËS DHE FAMILJES?

Reforma e shërbimeve sociale

KOMF ka mbështetur reformën e shërbimeve sociale përmes hartimit të Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare për pesë vite me radhë. Ky ligj hyri në fuqi në janar 2024, duke hapur rrugën për zhvillimin e reformës. KOMF përgjatë vitit u përfshi si anëtar në grupet punuese për hartimin e 22 udhëzimeve administrative që burojnë nga ky ligj. Po ashtu, KOMF u bë anëtar i paneleve në nivel nacional, të themeluara bazuar në ligjin e ri, si: paneli për adoptim, paneli për strehim familjar dhe paneli për strehim rezidencial.

Financimi i shërbimeve sociale

Përballë krizës së financimit të krijuar në janar 2024, si Koalicion u mobilizua fuqishëm dhe avokuam për të gjetur një zgjidhje emergjente për financimin e këtyre shërbimeve jetike. Adresuam kërkesa drejt Qeverisë, Kuvendit dhe komunave, duke alarmuar për rrezikun e mbylljes së shërbimeve për fëmijë.

Për herë të parë, gjatë vitit 2024,

organizuam një protestë së bashku me ofruesit e shërbimeve sociale dhe prindërit e fëmijëve përfitues, për të ngritur zërin ndaj krizës së krijuar në financimin e shërbimeve sociale për fëmijët në nevojë.

Përmes angazhimit të përbashkët, arritëm të ndikojmë në marrjen e një vendimi nga Qeveria e Republikës së Kosovës për subvencionimin emergjent të strehimoreve dhe organizatave joqeveritare që ofrojnë shërbime sociale



për fëmijë, duke parandaluar mbylljen e tyre. Po ashtu, bazuar në Deklaratën Financiare të Ligjit të ri për Shërbime Sociale, buxheti për financimin e shërbimeve sociale nga niveli qendror u rrit nga 1.5 milionë në 2.5 milionë euro.





Mobilizimi për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

Përpjekjet për mobilizimin e institucioneve për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës vazhduan edhe gjatë vitit 2024. KOMF dhe Terre des Hommes mbajtën dy tryeza diskutimi rreth zbatimit të këtij ligji, me rreth 100 përfaqësues nga komunat e Kosovës.

Këto tryeza shërbyen për të diskutuar dhe shkëmbyer përvojat mbi nivelin e zbatimit të ligjit në secilën komunë. Qëllimi ishte sensibilizimi dhe mobilizimi i komunave dhe profesionistëve për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, duke mundësuar kështu ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme për fëmijët.



Kujdesi alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror



Në prag të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, KOMF u prit nga deputetët e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për të diskutuar rreth shërbimeve sociale për fëmijët dhe familjet në Kosovë. KOMF i informoi deputetët për gjendjen e shërbimeve sociale, si dhe për hapat e nevojshëm për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet.

Po ashtu, KOMF shënoi Ditën Ndërkombëtare të Familjes në ambientin familjar të familjes strehuese Aziz dhe Alie Hamdiu në Komunën e Gjilanit, bashkë me familjet strehuese, Organizatën për Fëmijët pa Kujdes Prindëror, Ministren e Drejtësisë, Kryetarin e Komunës së Gjilanit dhe UNICEF në Kosovë.

Opinion i KOMF për rishikimin e shtesave për fëmijë

KOMF ka propozuar rishikimin e skemës ekzistuese, për të përfshirë fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (aktualisht skema përfshin vetëm fëmijët deri 16 vjeç). Përfshirja e të gjithë fëmijëve është e nevojshme, veçanërisht duke pasur parasysh mungesën e skemave mbështetëse për grupmoshën e fëmijëve 16–18 vjeç. KOMF ka kërkuar krijimin e procedurave për përfitim të shtesave për fëmijë për fëmijët pa kujdes prindëror, të cilët aktualisht nuk gëzojnë këtë të drejtë. Po ashtu, është kërkuar hartimi i bazës ligjore për këtë skemë, për të siguruar qëndrueshmëri, duke qenë se shtesat për fëmijë ofrohen në bazë të një vendimi.

Opinion i KOMF mbi abuzimin seksual të fëmijëve

Duke u bazuar në rritjen e vazhdueshme të rasteve të abuzimit seksual ndaj fëmijëve, KOMF ka publikuar një opinion mbi këtë çështje. Këto raste janë pasojë e neglizhencës shumëvjeçare dhe e mosveprimit adekuat të institucioneve në parandalimin e dhunës dhe abuzimeve seksuale, si dhe tregues i dështimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në trajtimin e rasteve kur ata janë viktimë të krimeve kundër integritetit seksual. KOMF adresoi rekomandimet drejt institucioneve për ndërhyrje të menjëhershme.



Adresimi i prioriteteve drejt Komitetit Ndërmnishtor për të Drejtat e Fëmijëve

KOMF përfaqëson organizatat e shoqërisë civile në Komitetin Ndërmnishtor për të Drejtat e Fëmijëve, si mekanizmi më i lartë bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës. Gjatë vitit 2024, në dy takime të ndara, KOMF adresoi çështje emergjente për mbrojtjen e fëmijëve para Kryeministrit, Ministres së Arsimit dhe përfaqësuesve të tjerë. KOMF theksoi nevojën për rritje të buxhetit për funksionalizimin e shërbimeve sociale; gjithëpërfshirjen

kuptimplotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor; rritjen e burimeve njerëzore për shëndetin mendor të fëmijëve në institucionet publike shëndetësore; themelimin e shërbimeve të specializuara për mbrojtjen e fëmijëve viktimë të abuzimit me substanca narkotike; fuqizimin e shërbimeve rehabilituese për të miturit në konflikt me ligjin.

ÇFARË KEMI BËRË PËR ARSIMIN NË VITIN 2024

Arsimi në rënie të lirë!

KOMF mbajti Konferencën për Media të dedikuar arsimit në Kosovë: “Arsimi në rënie të lirë”. Paneli i përbërë nga anëtarët e KOMF adresoi qëndrimet për gjendjen e arsimit në Kosovë, duke u fokusuar në cilësinë e arsimit, mbrojtjen e fëmijëve në shkolla, gjithëpërfshirjen, parandalimin e braktisjes, si dhe risitë e sfidat e modelit të mësimin tërë-ditor. Arsimi parauniversitar në Kosovë përballlet me shumë sfida që ndikojnë negativisht në cilësinë e tij. Sipas Raportit Monitorues të KOMF “Karta e Vlerësimit”, puna e institucioneve publike arsimore në Kosovë është vlerësuar me notën 2.5 në një shkallë nga 1 deri në 5.



Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këtë gjendje janë: Planprogrami i mbingarkuar; Cilësia e pamjaftueshme e mësimdhënies; Numri i lartë i nxënësve në klasa, sidomos në qytete; Shkolla dhe klasa me numër shumë të vogël nxënësish, përfshirë klasat e kombinuara në zonat rurale; Qëndrimi i shkurtër në shkolla; Mungesa e infrastrukturës adekuate; Mungesa e aktiviteteve jashtëkurrikulare; Menaxhimi i dobët i shkollave; Politizimi i kuadrit arsimor; Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet prindërve, mësimdhënësve dhe nxënësve; Llogaridhënia e ulët; Ndërrprerjet e shpeshta të procesit mësimor, përfshirë grevat në arsim.

Avokimi drejt komunave për arsimin

KOMF ka adresuar përmes një dokumenti të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të Kartës së Vlerësimit drejt 38 Kryetarëve të Komunave dhe Drejtorëve të Drejtorive



Komunale të Arsimit. Arsimi rezulton ndër fushat me vlerësimin më të ulët, prandaj KOMF kërkoi që komunat të shqyrtojnë me prioritet rekomandimet dhe të ndër-marrin hapat e nevojshëm për përmirësimin e situatës së fëmijëve në arsim, duke u bazuar në përgjegjësitë institucionale.

Opinion i KOMF për edukatën seksuale në shkolla

Edukata seksuale është një pjesë thelbësore e zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve, duke ndikuar drejtpërdrejt në shëndetin e tyre fizik, emocional dhe mendor. KOMF ka kërkuar rishikimin dhe redaktimin e teksteve, doracakëve dhe materialeve të tjera mësimore që lidhen me këtë fushë, për të shmangur keqkuptimet dhe interpretimet e ndryshme nga profesionistët të ngritura gjatë vitit 2024.

KOMF theksoi se nuk duhet të lejohet asnjë iniciativë që synon heqjen e edukatës seksuale nga shkollat, pasi një veprim i tillë do të nënkuptonte mohim të së drejtës themelore të çdo fëmije për të qenë i informuar dhe i mbrojtur.



ÇFARË KEMI BËRË PËR SHËNDETIN E FËMIJËVE NË VITIN 2024

Rregullimi i statusit të OJQ-ve në ofrimin e shërbimeve shëndetësore



KOMF ka adresuar drejt Ministrit të Shëndetësisë sfidat e organizatave joqeveritare në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, për shkak të mosrregullimit të statusit të tyre ligjor. Rreth 50 OJQ ofrojnë shërbime të integruara shëndetësore e sociale, por nuk janë të licencuara si ofrues të shërbimeve shëndetësore, për shkak të supozimeve për mangësi ligjore në Ligjin për Shëndetësi.

Ligji për Shëndetësi përmban dispozita kontradiktore lidhur me ofrimin e shërbimeve nga OJQ-të dhe licencimin e tyre. KOMF kërkoi që Ministria e Shëndetësisë të ndërmarrë masa për të siguruar një kujdes shëndetësor të qasshëm dhe të barabartë për të gjithë ofruesit e shërbimeve – publikë, privatë dhe joqeveritarë.



ÇFARË KEMI BËRË PËR DREJTËSINË PËR FËMIJË NË VITIN 2024



Zhvillimi i Kurrikulës për Fëmijë në sistemin e drejtësisë

KOMF ka mbështetur hartimin e Kurrikulës për sistemin e drejtësisë për fëmijë, në kuadër të Akademisë së Drejtësisë, e përbërë nga 13 module në fushën penale dhe civile. Qëllimi i përgjithshëm i kurrikulës është të forcojë sistemin e drejtësisë për fëmijët dhe të miturit në Kosovë, të përmirësojë njohuritë dhe aftësitë e profesionistëve të drejtësisë në lidhje me të drejtat e fëmijëve, drejtësinë për të mitur dhe procedurat ligjore që ndikojnë tek ta.

Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve të sistemit të drejtësisë



KOMF ka mbështetur zhvillimin e Trajnimit për Trajnerë, bazuar në Programin e ri Kurrikular për Fëmijë për sistemin e drejtësisë, në modulet: fusha civile – mbrojtja e të

drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit; mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre; mbrojtja gjyqësore e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror; si dhe nga fusha penale – veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve; procedura penale që zhvillohet ndaj të miturve dhe veprimi me fëmijët.

Zbatimi i masave të diversitetit

KOMF ka mbështetur hartimin e “Procedurës Standarde të Veprimit dhe formës për shqiptimin e masës së diversitetit - Vërejtja Policore”, e hartuar në kuadër të Policisë së Kosovës. Masa e diversitetit “Vërejtja Policore” për të miturit në konflikt me ligjin, përkundër faktit se prej vitit 2018 është përfshirë në Kodin e Drejtësisë për të Mitur, është zbatuar minimalisht. Prandaj ky proces shënon një moment të rëndësishëm që pritet të ndikojë në rritjen e shqiptimit të kësaj mase, përmirësimin e sistemit të drejtësisë për të mitur, parandalimin e procedurës gjyqësore, nxitjen e rehabilitimit dhe parandalimin e sjelljeve recidiviste të të miturve.



KARTA E VLERËSIMIT

Kosova merr notën 2.43 në kujdesin ndaj femijeve

KOMF, ka publikuar edicionin e dytë të Raportit të Monitorimit “Karta e Vlerësimit” – Cili është rezultati i përgjithshëm i Kosovës për kujdesin ndaj fëmijëve? Kosova është vlerësuar me notën 2.43 në kujdesin ndaj femijeve, në një shkallë nga 1 deri në 5, duke rezultuar me sistem të brishtë të mbrojtjes së femijeve.

Raporti u publikua në Qeverinë e Republikës së Kosovës, me prezencën e Kryeministrit, Ministres së Drejtësisë, Ministres së Arsimit, Zëvendësministrit të Shëndetësisë, deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, zyrtarëve të ministrive përkatëse, institucioneve komunale, agjencive ndërkombëtare, organizatave joqeveritare, si dhe partnerëve të tjerë.

Qëllimi kryesor i KOMF, përmes këtij raporti, është monitorimi i pavarur i shoqërisë civile mbi gjendjen e të drejtave të fëmijëve në fushën e mirëqenies sociale, mbrojtjes së fëmijës, shëndetit të fëmijës, zhvillimit në fëmijërinë e hershme, arsimit dhe drejtësisë për të mitur.

KOMF poashtu ka adresuar të gjetjet dhe rekomandimet kryesore të dala nga Raporti i Monitorimit “Karta e Vlerësimit” drejt komunave të Kosovës. KOMF ka mbajtur shtatë tryeza, ku janë përfshirë të gjitha komunat e Kosovës, me pjesëmarrjen e rreth 250 përfaqësuesve nga komunat dhe drejtoritë komunale, Qendrat për Punë Sociale, Qendrat e Mjekësisë Familjare, Qendrat e Shëndetit Mendor, spitalet rajonale, Prokuroritë dhe Gjykatat Themelore, Policia e Kosovës, psikologët shkollorë dhe organizatat joqeveritare.



KË E VLERËSUAM PËR KONTRIBUTIN NË FUSHËN E MBROJTJES SË FËMIJËVE NË 2024

Për të dymbëdhjetin vit me radhë, kemi vlerësuar gazetarë, individë, biznese dhe kompani që kanë kontribuar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre. KOMF, në bashkëpunim me fondacionin Terre des hommes - Kosovo, ka mbajtur ceremoninë e ndarjes së çmimeve vjetore për gazetarë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe mirënjohjeve vjetore “Mik i fëmijëve” për kontribuuesit në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë.

ÇMIMET VJETORE 2024 NË FUSHËN E GAZETARISË:



- **Blerta Ahmeti**, Betimi për Drejtësi, për hulumtimin që shpalos problemet me të cilat ballafaqohen fëmijët gjatë procesit të divorcit të prindërve.



- **Bujar Vitija**, KOSOVO 2.0, për shkrimin që trajton një temë kritike i: shëndetin dhe mirëqenien e foshnjave dhe nënave në Kosovë.



- **Blerta Zuka**, T7, për emisionin që ndriçon një realitet të dhimbshëm të fëmijëve të komuniteteve të marginalizuara në Kosovë.

MIQTË E FËMIJËVE 2024:



- Familja strehuese Ganimete dhe Veli Memaj nga Komuna e Prizrenit u vlerësua për kujdesin e 13 fëmijëve pa kujdes prindëror.



- Institucioni Mikrofinanciar FINCA Kosova u vlerësua për mbështetjen me 10 asistentë për fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshte dhe shkolla.



- Artan Hasani u vlerësua për dhurimin e parcelës së tokës për ndërtimin e një shtëpie pushimi apo qendre trajnimi për fëmijët pa kujdes prindëror.



- Banka për Biznes – BPB u vlerësua për kontributin në qëndrueshmërinë e shërbimeve terapeutike për fëmijët me sindromën Doën.



- ProCredit Bank Kosova u vlerësua për mbështetjen e fushatave për mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve në nevojë.



- Cycle Kosovo for Children (CKC – grupi i çiklizmit) u vlerësua për mbështetjen e sektorit shëndetësor në Kosovë.

KOMF NË MEDIA



Prezenca në media

Në vitin 2024, kemi dërguar mbi 30 komunikata, njoftime, reagime në media – opinione mbi temat për fëmijët, ku kemi arritur mbi 300 përmendje në media.

Ndërsa në platformat e mediave sociale, kemi pasur 1.5 milion arritje.

Buletini informativ është publikuar çdo tre muaj dhe është dërguar tek mbi 500 përfaqësues të institucioneve publike, organizatave joqeveritare, trupa diplomatik dhe agjencive ndërkombëtare.

Është realizuar një video me gjetjet nga Karta e Vlerësimit, me synim ndërgjegjësimin e publikut. Kjo video ka arritur mbi 340,000 shikime në rrjetet sociale.

KOMF dhe Komisioni i Pavarur i Mediave – KPM nënshkruan Deklaratën e përbashkët lidhur me mbrojtjen e fëmijëve në media. Qëllimi i kësaj deklarate është siguri i bashkëpunimit dhe ndërveprimit të në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave – KPM, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe KOMF, për mbrojtjen e fëmijëve në media.

Temat që tërhoqën më shumë interesin e medias:

- Protesta: "Shërbimet për fëmijët po mbyllen – alarm për Qeverinë, Komunitetin dhe Kuvendin"
- Karta e Vlerësimit 2024
- Çmimet Vjetore për Gazetarë dhe Mirënjohjet "Mik i Fëmijëve"




ZHVILLIMI I KOMF

Vlerësimi i nevojave

KOMF ka zhvilluar procesin e vlerësimit të nevojave, me qëllim të identifikimit të pikave të forta, sfidave, nevojave dhe mundësive të KOMF dhe organizatave anëtare për zhvillim të mëtejshëm. Ndër rekomandimet kryesore ishin: krijimi i një programi për ngritjen e kapaciteteve për KOMF dhe organizatat anëtare; riorganizimi i grupeve tematike, diversifikimi i burimeve të financimit, rritja e kuotës së anëtarësisë, etj.

Programi për ngritje të kapaciteteve

Ngritja e kapaciteteve të KOMF dhe organizatave anëtare konsiderohet si proces i vazhdueshëm. Për këtë qëllim, KOMF ka hartuar Programin për Ngritje të Kapaciteteve, i cili përmban strukturë modulare dhe është përpiluar me qëllim të forcimit të kapaciteteve të OJQ-ve. Programi përmban modulet në vazhdim: Qeverisja e mirë dhe menaxhimi i organizatës; Procedurat e brendshme të organizatës për mbrojtjen e fëmijës; Avokimi dhe komunikimi dhe Mbledhja e fondeve dhe vullnetarizmi.



Veprimet për ngritje të kapaciteteve

Gjatë vitit 2024, në kuadër të Programit për Ngritje të Kapaciteteve, u organizuan katër trajnime për trajnerë me organizatat anëtare të KOMF. Si rezultat i këtij procesi, 20 anëtarë u certifikuan si trajnerë në katër modulet kryesore të programit: Qeverisja e mirë dhe menaxhimi i organizatës; Procedurat e brendshme për mbrojtjen e fëmijës; Avokimi dhe komunikimi; si dhe Mbledhja e fondeve dhe vullnetarizmi. Ky proces pritet të kontribuoj ndjeshëm në fuqizimin e organizatave anëtare, duke rritur aftësitë e tyre për të ofruar trajnime të brendshme, për të përmirësuar praktikën organizative dhe për të siguruar qëndrueshmëri më të madhe.



Takimi i Asamblesë së Përgjithshme

KOMF mbajti takimin e Asamblesë së Përgjithshme, gjatë të cilit anëtarët aprovuan raportin narrativ dhe financiar për vitin 2023. Në këtë takim u prezantuan gjithashtu të gjeturat dhe rekomandimet kryesore nga raporti “Vlerësimi i Nevojave të KOMF”, ndërsa u morën vendime për riorganizimin e grupeve tematike dhe rritjen e pagesës së anëtarësisë.

Gjithashtu, u mbajtën zgjedhjet për Bordin Drejtues dhe Presidentin e KOMF për mandatin e ardhshëm dyvjeçar. Asambleja e Përgjithshme zgjodhi:

- Remzije Krasniqi, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë – Presidente e KOMF
- Sebahate Hajdini Beqiri, Doën Syndrome Kosova – Anëtare e Bordit Drejtues
- Ibadete Krasniqi, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror (OFAP) – Anëtare e Bordit Drejtues
- Gani Lluga, ASTRA – Anëtar i Bordit Drejtues
- Rexhep Sefedin Gojnovci, Organizata Rinore Akti – Anëtar i Bordit Drejtues



RIORGANIZIMI I GRUPEVE TEMATIKE



Bazuar në vlerësimin e nevojave, gjatë 2024 u bë ri organizimi i grupeve tematike duke pasur për bazë ciklin jetësor apo moshën e fëmijëve dhe jo ndarjen në sektorë, duke i trajtuar kështu fëmijët në mënyrë holistike, nga lindja e deri në pavarësimin e tyre të plotë. Modeli i propozuar është si vijon:

Grupi Tematik për Zhvillimin në Fëmijërinë e Hershme do të bazohet në ekspertizën e organizatave anëtare që punojnë në zhvillimin në fëmijërinë e hershme nga lindja deri në moshën **tetë vjeç**.

Grupi Tematik për Mbrojtjen Sociale dhe Shëndetin e Fëmijëve dhe Familjeve do të luan një rol vendimtar në fushën e mbrojtjes sociale dhe shëndetit për fëmijët dhe familjet.

Grupi Tematik për Arsimin dhe Rininë, do të fokusohet në adresimin e çështjeve për fuqizimin e arsimit dhe fuqizimin e rinisë.

Gjatë vitit 2024, grupet tematike zhvilluan takime të rregullta, ku u morën vendime dhe u planifikuan veprimet dhe nismat për veprimtarinë e KOMF në fushën e shërbimeve sociale, mbrojtjes së fëmijëve, shëndetit, zhvillimit të fëmijërisë së hershme dhe arsimit.



DONATORËT PËR VITIN 2024

UNICEF në Kosovë

Zyra e Bashkimit European në Kosovë

SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor” të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA).

Terre des hommes në Kosovë

ORGANIZATAT ANËTARE TË KOMF

- Aksioni për Nëna dhe Fëmijë
- Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim
- Balkan Sunflowers Kosova
- Childproof/CIPOF
- CONCORDIA Projekte Sociale
- Down Syndrome Kosova
- Education Comes First
- Handikos Ferizaj
- Handikos Gjakovë
- Hareja
- Network of Peace Movement
- Nevo Koncepti
- OPFAKKOS
- Organizata “Autizmi”
- Organizata Akti
- Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP
- Organizata Zë
- PLAY International
- Programi për të Drejtat Civile
- Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS
- Qendra e Kujdesit Ditor PEMA
- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT
- Qendra Labyrinth
- Qendra për Arsim e Kosovës – KEC
- Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore
- Qendra për Studime të Avancuara – FIT
- Qendra Sociale Edukative SOS Kopshti
- Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshata
- Save the Children në Kosovë
- SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë
- Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS
- Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova
- Terre des hommes Kosovo
- The Ideas Partnership

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF

Web: www.komfkosova.org

Facebook: komfkosova

Instagram: komfkosova